



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E PROKURIMIT PUBLIK
DREJTORIA JURIDIKE DHE E INTEGRIMIT

Të dhëna mbi Vendimin e APP Nr. 25, datë 15.03.2019

Agjencia e Prokurimit Publik (në vijim "APP") në mbështetje të nenit 13/3/a të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, në ushtrim të kompetencave të saj me Vendimin Nr. 21, datë 05.03.2019, ka vendosur të përjashtojë për **3 (tre) vjet** operatorin ekonomik "Avduli" Shpk me NIPT J66703306O, nga pjesëmarrja në procedurat e prokurimit publik, pasi ka keqinformuar dhe ka paraqitur dokumentacion me të dhëna të rreme për qëllime kualifikimi.

I. Arsytet e heqjes së emrit të operatorit ekonomik nga lista e operatorëve ekonomikë të përjashtuar nga pjesëmarrja në procedurat e prokurimit publik:

Kundër Vendimit Nr. 21, datë 05.03.2019 të APP, shoqëria "Avduli" Shpk, i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, duke kërkuar shfuqizimin e vendimit të dhënë nga APP Nr. 21, datë 05.03.2018.

Me vendimin Nr. 86 Akti, datë 11.03.2019, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Vlorë, ka vendosur pranimin e kërkesë padisë, duke urdhëruar pezullimin e zbatimit të vendimit administrativ të APP Nr. 21, datë 05.03.2018.

Në këto kushte APP, në mbështetje të nenit 180, pika 1, gërma "b" i Ligjit Nr. 44/2015 të Kodit të Procedurës Administrative, nëpërmjet Vendimit Nr. 25, datë 15.03.2019, ka vendosur pezullimin e Vendimit Nr. 21, datë 05.03.2019, deri në marrjen e një vendimi përfundimtar nga Gjykata Administrative e Apelit Vlorë, duke proceduar me heqjen e këtij operatori ekonomik nga lista e operatorëve ekonomikë të përjashtuar nga pjesëmarrja në procedurat e prokurimit publik.